

Ndodhur në kushtet e moskthimit të përgjigjes rreth rekomandimit, në afatin ligjor të bërë të ditur, i është kërkuar, z.Petani, me shkresën nr.K3/F52-4 prot, datë 18.04.2016, kthimi i përgjigjes rreth rekomandimit të dhënë. Edhe pse kanë kaluar më shumë tre muaj nga data e dërgimit të rekomandimit, pa shkak të bërë të ditur, nuk është bërë dhe nuk bëhet e mundur përmbushja e detyrimit prej z.Petani, për kthimin e përgjigjes rreth rekomandimit të dhënë.

Referuar përgjegjësi të Ministrisë së Drejtësisë, sikurse parashikuar në nenin 10 të ligjit nr.10031, datë 11.12.2008, të ndryshuar, duke e vlerësuar të parregullt veprimtarinë e Përmbuesit Gjyqësor Privat, në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 727, datë 14.07.1999 të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, Durrës, Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në sanksionimin e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, se : “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike*”, si dhe nenin 21/b, të ligjit nr.8454, date 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen*”.

REKOMANDON

Ushtrimin e kontrollit mbi veprimtarinë e Përmbuesit Gjyqësor Privat, z.Lorval Petani, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr. 727, datë 14.07.1999, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë;

Kopje të shkresës nr. K3/F52-3 prot, datë 26.02.2016, të Avokatit të Popullit drejtuar Përmbuesit Gjyqësor Privat, z.Lorval Petani

Kopje të shkresës nr. K3/F52-4 prot, datë 18.04.2016, të Avokatit të Popullit drejtuar Përmbuesit Gjyqësor Privat, z.Lorval Petani

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**